



# KOLEGJI ILIRIA

Licensuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Rruga Gazmend Zajmi Nr. 75 Prishtinë, Të: +381 (0) 38 233 951 E-mail: info@uiliria.org Web: www.uiliria.org

*Në bazë të nenit 17 paragrafi 15 dhe 16 të Statutit të Kolegjit ILIRIA të vitit 2012, Rektorati pranë Kolegjit, me datë 05/09/2014 mori këtë;*

## V E N D I M PËR ORGANIZIMIN E LIGJËRATAVE DHE USHTRIMEVE NË VITIN AKADEMIK 2014/2015

- I. Aprovohet fillimi i procesit mësimor, përkatësisht fillimi dhe kohëzgjatja e ligjëratave dhe ushtrimeve gjatë vitit akademik 2014/2015 për studentët e regjistruar pranë Kolegjit ILIRIA.
- II. Konstatohet se ligjëratat dhe ushtrimet në këtë vit akademik sipas statutit do të organizohen në dy semestra atë dimëror dhe veror.
- III. Ligjëratat në semestrin dimëror në të gjitha programet, gjatë vitit akademik 2014/2015 të fillojnë më 03 nëntor 2014 dhe të përfundojnë më 15 shkurt 2015.
- IV. Nga data 16 shkurt 2015, në periudhë një mujore deri në datë 15 mars 2015 është periudha e pushimit semestral.
- V. Ligjëratat në semestrin veror në të gjitha programet, gjatë vitit akademik 2014/2015 të fillojnë më 16 mars 2015 dhe të përfundojnë më 28 qershor 2015.
- VI. Urdhërohen njësitë akademike sipas kërkesës dhe nevojës së studentëve dhe të dekanatit të njësisive akademike të organizohen edhe ligjëratat dhe ushtrime intenzive shtesë jashtë programit zyrtar të paraparë në bazë të rëndësisë në këto periudha: a) Një javë para afatit të provimeve; b) Dy javët e para të shtatorit c) Në kohëzgjatje prej dy javësh pas përfundimit të semestrit dimëror; d) Dy javë gjatë muajit Korrik.

### A r s y e t i m

Bazuar në Statutin e Kolegjit ILIRIA, ligjëratat për një semestër zgjasin 15 javë (3.5 muaj). Kolegji ILIRIA u ofron ligjëratat dhe ushtrime shtesë pa pagesë, sipas kërkesës së studentëve apo konstatimit nga dekanati i njësisë akademike.

Bazuar në Statutin e Kolegjit ILIRIA viti akademik fillon me 01 Tetor dhe përfundon me 30 Shtator. Koha e fillimit të ligjëratave dhe ushtrimeve duhet të organizohet brenda këtij intervali kohor, por jo domosdoshmërisht të përputhet me kohën e fillimit të vitit akademik.

Rektori

